



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**THIRRJE PËR EKSPERTË TË JASHTËM**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkon ekspertë të jashtëm të kualifikuar në fushën e mediave audiovizive për hartimin e Dokumentit Strategjik dhe Planit të Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për periudhën 2024-2026.

**TERMAT E REFERENCËS**

**Objektivi**

Dhënia e asistencës së nevojshme për hartimin e Dokumentit Strategjik dhe Planit të Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për 3 vjeçarën 2024-2026, duke përcaktuar qëllimet strategjike të AMA-s, objektivat specifike si dhe masat dhe aktivitetet për arritjen e qëllimeve;

Detyrat:

Eksperti, nëpërmjet dokumentit që do të dorëzojë duhet të:

1. Të parashikojë misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të autoritetit për periudhën 2024-2026;
2. Të marrë parasysh që Strategjia të përfshijë nevojën për sigurimin e përdorimit sa më të frytshëm, të dobishëm dhe përfitues të burimeve të AMA-s;
3. Të përfshijë një studim të frytshmërisë dhe dobishmërisë të dokumentit gjatë kohës së zbatimit të saj;
4. Dokumenti final duhet të jetë i shoqëruar me një plan veprimi;
5. Të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive gjatë hartimit të dokumentit;
6. Nëpërmjet strategjisë së AMA-s duhet të bëhen të qarta fuqitë ligjore të rregullatorit;
7. Strategjia duhet të përmbajë objektiva të qarta dhe plan veprimi konkret.

**Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:**

1. Të zotërojë diplomën e shkollës së lartë në shkenca shoqërore.
2. Të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë në fushën e mediave audiovizive;
3. Të njohë kuadrin rregullator i cili rregullon tregun audioviziv si dhe të njohë zhvillimet e fundit në këtë fushë;
4. Të njohë procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive;
5. Të ketë eksperiencë të mëparshme në hartimin e strategjive dhe /ose raporteve institucionale;

### **Përbën avantazh:**

- Kandidatët me përvojë pune mbi 5 vite në mësimdhënie në nivelet Bachelor ose Master në Shkenca e Komunikimit ose Gazetarisë;
- Kandidatët që kanë pjesëmarrje në grupe pune për ekspertizë ose studime mbi aspekte të zhvillimit të medias në Shqipëri (të paraqiten referencat përkatëse);

### **Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:**

1. Diploma e shkollës së lartë në shkenca shoqërore;
2. Dokumentacioni që vërteton punë të ngjashme;
3. Fotokopje e librezës së punës që vërteton vitet e eksperiencës;
4. Jetëshkrimi;
5. Kopje ID/Pasaportë;

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

- |  |         |
|--|---------|
| 1. Diploma e shkollës së lartë;                            | 40 pikë |
| 2. Librezën e punës ku të vërtetohen vitet e eksperiencës; | 20 pikë |
| 3. Dokumentacioni për punë të ngjashme;                    | 20 pikë |
| 4. Jetëshkrimi;  | 20 pikë |

**Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 04 Shtator 2023, ora 12:00, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AMA-s.**

**Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, 1010, Tiranë**

